

SITUATA E EMERGJENCËS NGA KORONAVIRUS SARS-COV-2


Shpjegimi i Modaliteteve

- ✚ Të lejohet hyrja në farmaci e një numri maksimal pacientësh të barabartë me numrin e vendeve të shërbimit në banakun e farmacisë.
- ✚ Rregullimi i numrit të hyrjes së pacientëve sipas pikës së mësipërme mund të bëhet duke mbyllur derën e hyrjes së farmacisë, ku në një vend të dukshëm të **shkruhet mesazhi i mëposhtëm:**

*“Me qëllim mbrojtjen e pacientëve dhe të personelit të farmacisë, duhet ruajtur distanca e nevojshme për të kufizuar mundësinë e kontaktit.
Lutemi ruajtjen e një distance prej të paktën 1 metër nga personat e tjerë dhe evitimin e grumbullimit në brendësi të farmacisë”
Faleminderit!*

Me synim disiplinimin e hyrjes mund të aplikohen edhe lëshimi i numrave të radhës, nëse farmacia disponon pajisjen që lëshon një të tillë;

- ✚ Të garantohet distanca prej të paktën 1 metër si ndërmjet pacientëve me njëri-tjetrin, ashtu edhe ndërmjet pacientëve dhe farmacistëve dhe farmacistëve mes tyre.
- ✚ T’i jepet prioritet hyrjes së pacientëve të moshuar, atyre me aftësi të kufizuar si dhe grave shtatzëna.



MËNYRA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE FARMACEUTIKE


Duke patur në konsideratë faktin që shërbimi farmaceutik bën pjesë në shërbimet shëndetësore esenciale, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së këtij shërbimi ndaj popullatës, farmacitë e rrjetit të hapur duhet të konfirmojnë praninë e personelit të farmacisë përgjatë gjithë orarit të hapjes. Këto farmaci mund të punojnë me dyer të hapura ose të mbyllura (në rastet kur farmacia i ka mundësitë e hapjes së një sporteli komunikues).

Është e rëndësishme të evitohen grumbullimet e njerëzve brenda ose jashtë ambienteve të farmacisë (rë rastin kur punohet me sportel).

Në rastin e farmacive që punojnë me dyer të hapura, të disiplinohet hyrja e pacientëve me hapje të kontrolluar të derës së hyrjes konform indikacioneve operacionale për farmacistët (shtojca 1).

Sistemet e mbrojtjes dhe mjetet e mbrojtjes individuale

Me qëllim mbrojtjen e farmacistëve dhe të punonjësve të tjerë të farmacisë të cilët e zhvillojnë aktivitetin në një distancë të afërt me publikun, sugjerohet përdorimi i paneleve mbrojtës transparente të cilët mund të vendosen përgjatë gjithë banakut të farmacisë.



Masat e sigurisë të tipit kolektiv dhe personal

Dezinfektimi

- + Vendosje në ambientet e farmacisë të shpërndarësve automatikë të dezinfektantëve për duart.
- + Dezinfektim i përditshëm manual i të gjitha sipërfaqeve të arritshme.
- + Të vlerësohet mundësia e vendosjes së aparateve dezinfektuese në formë nebulizatori për ambientin,
- + Të vlerësohet mundësia e vendosjes së aparateve që ndërrojnë/pastrojnë ajrin,
- + Personeli i farmacisë të mbajë doreza njëpërdorimëshe mundësisht më të gjata se kyçi i dorës.
- + Personeli i farmacisë të mbajë maska filtruese të certifikuara për mbrojtjen ndaj agjentëve infektivë.
- + Personeli i farmacisë të veshë këmbisha mbrojtëse të certifikuara për mbrojtjen ndaj agjentëve infektivë.

Dezinfektimi i ambienteve, sipërfaqeve dhe ajrosja e ambienteve


- + Rekomandohet pastrim i kujdesshëm i ambienteve të farmacisë me dezinfektantë me bazë alkoolin ose klorin (sidomos banakut dhe zonave të afërta me të).
- + Rekomandohet larja sa më e shpeshtë e duarve dhe ajrosja sa më e shpeshtë e ambientit të farmacisë.

Shërbimet e kryera në farmaci (matje të tensionit, glicemisë etj)

Sugjerohet të lejohen vetëm ato shërbime që janë të domosdoshme dhe urgjente. Edhe në këto raste duhet respektuar distanca prej 1 metër (për pasojë farmacisti nuk mund të ndërveprojë direkt me pacientin, por mund të kryejë vetëm mbështetje në realizimin e autoanalizës që pacienti do të kryejë, duke ruajtur distancën prej 1 metri). Në çdo rast këshillohet përdorimi i dorezave dhe i maskave.

INDIKACIONE OPERACIONALE PËR FARMACISTËT

- ✚ Të evitohen grumbullimet e personave, duke siguruar hyrjen e rregulluar të tyre, përmes mbylljes së përkohshme të derës hyrëse.
- ✚ Të garantohet distanca minimale prej 1 metër mes pacientëve, pacientëve dhe farmacistëve si dhe farmacistëve ndërmjet tyre.
- ✚ Në zonat me risk të lartë të vishen mjetet mbrojtëse: maska dhe doreza.
- ✚ Të bëhen të disponueshme për pacientët mjete për higjenën dhe dezinfektimin e duarve.
- ✚ Të lahen shpesh duart dhe të evitohet kontakti me gojën, hundën dhe sytë.
- ✚ Të pastrohet me kujdes ambienti me dezinfektues me bazë alkooli ose klori, duke patur kujdes të veçantë për banakun dhe zonat përreth tij.
- ✚ Të nebulizohet në ambient spray higjenizues.
- ✚ Të vendosen në vende të dukshme të gjithë informacionet e kërkuara nga strukturat e shëndetit publik.
- ✚ Të ndërpriten praktikat mësimore përgjatë gjithë kohës së ndërprerjes së aktivitetit mësimor në universitete.
- ✚ Të menaxhohen kontaktet me furnizuesit në mënyrë të tillë që të kufizohen kontaktet me pacientët.



Materiali u përgatit bazuar në rekomandimet e:
Federazione per i servizi degli Ordini dei farmacisti della Lombardia